

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 66/2013 dhe 114/2014), dhe nenit 31, nenit 32 dhe nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14/2022 të datës 20 janar 2022), duke vepruar mbi kërkesën për miratimin e mendimit juridik për unifikimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 12.07.2022, miratoi këtë:

M E N D I M J U R I D I K

Për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore, me të cilat përcaktohen masa të përkohshme si mjete për sigurimin e kërkesës, kompetent është përmbarruesi sipas Ligjit për përmbarrim.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sektorin e veprave civile, është parashtruar kërkesë për miratimin e mendimit juridik, lidhur me çështjen se cili organ është kompetent për zbatimin dhe përmbarrimin e veprimeve të përcaktuara me aktvendimet e miratuara gjyqësore për lëshimin e masës së përkohshme, përkatësisht vallë a janë ato gjykatat themelore sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin e kërkesave ose kompetentë janë përmbarruesit sipas Ligjit për përmbarrim. Nevoja për miratimin e mendimit juridik është e arsyetuar dhe mbështetur me shtesa, aktvendime të gjykatave, nga të cilat rrjedh praktikë jo e unifikuar gjyqësore si dhe shtesa nga të cilat rrjedh veprim i ndryshëm i përmbarruesve për kërkesat e parashtruara për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore me të cilat përcaktohet masë e përkohshme.

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke diskutuar për çështjen e parashtruar juridike e miratoi mendimin juridik, për këto arsye:

Sipas nenit 1 paragrafi (1) të Ligjit për sigurimin e kërkesave ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.87/2007, nr.31/2016), me këtë ligj përcaktohen mjetet për sigurimin e kërkesave, mënyra me të cilën përcaktohen ato, rregullat sipas të cilave vepron gjyqi me sigurimin e kërkesave, si dhe veprimi i noterit dhe veprimi i përmbarruesit në lidhje me këtë.

Sipas nenit 7 nga i njëjti ligj, në procedurën e sigurimit drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore dhe dispozitat e Ligjit për përmbarrim, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Sipas nenit 30 paragrafi (1) nga i njëjti ligj, në rastin kur nuk është ngritur procedurë kontestimore ose ndonjë procedurë tjetër gjyqësore për vendosje mbi propozimin për sigurim me masë të përkohshme dhe për zbatimin e masës së përkohshme, me kompetencë vendore është gjykata e cila do të vendoste në procedurën kontestimore. Në paragrafin 2 nga i njëjti nen është shënuar se nëse procedura është ngritur me propozim për sigurim me masë të përkohshme dhe për zbatimin e asaj mase të përkohshme, me kompetencë vendore është gjykata në të cilën është ngritur procedura.

Sipas nenit 1 paragrafi (1) të Ligjit për përmbarrim ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 72/2016, nr.142/2016, nr.233/2018 dhe "Gazeta zyrtare e RMV" nr.14/2020), me këtë ligj rregullohen rregullat, sipas të cilave përmbarruesit veprojnë për shkak të përmbarrimit të detyrueshëm të

vendimit gjyqësor që referohet në plotësimin e obligimit, përveç nëse me ligj tjetër nuk është caktuar ndryshe.

Sipas nenit 2 nga i njëjti ligj, bazë për përmbarim paraqet dokumenti përmbarues (paragrafi (1)). Përmbarimi fillon me kërkesë të kreditorit (paragrafi (2)).

Sipas nenit 12 paragrafi (1) pika 1 nga i njëjti ligj, dokumente përmbaruese janë vendimi gjyqësor dhe shlyerje gjyqësore.

Sipas nenit 230 paragrafi (1) nga i njëjti ligj, nëse sipas dokumentit përmbarues, debitori është i obliguar të kryejë veprim të caktuar të cilin në vend të tij nuk mund ta kryejë person tjetër, përmbaruesi me urdhër për përmbarim do t'i lërë debitorit afat të duhur për përmbushjen e obligimit.

Duke u nisur nga dispozitat e cituara, kur nga gjykata është miratuar aktvendim me të cilin është miratuar propozimi për sigurimin e kërkesës me masë të përkohshme, ndërsa kreditori ka parashtruar kërkesë për zbatimin dhe përmbarimin e veprimeve të përcaktuara me miratimin e vendimeve të plotfuqishme dhe përmbaruese gjyqësore, bëhet fjalë për zbatimin e përmbarimit të detyrueshëm të vendimit përmbarues gjyqësor. Në fakt, në situatën kur duhet të ndërmerren veprime konkrete për zbatimin e aktvendimit, përmbarimet e këtilla do t'i zbatojë përmbaruesi kompetent sipas dispozitave të Ligjit për përmbarim.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile